



Bazuar në dispozitat e nenit 108/A par. 1 dhe 3.2 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92-së dhe dispozitat nga neni 4 i Rregullave për parashtrim të ankesave – FO2, “N.P. T. “PASHTRIKU” Rr. Pal Palucaj Nr. 35 10000 Prishtinë – Republika e Kosovës në cilësi të palës së interesuar që ka interes juridik-material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit lidhur me këtë lëndë, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues – Njoftimit për Dhënie të Kontratës i publikuar me datë 06/05/2020; në web faqen e platformës elektronike të KRPP-së Kopje e VENDIMIT –

#### ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: Komuna e Ferizajit Rr. Dëshmorët e Kombit pn 70000 Ferizaj Republika e Kosovës

Për Aktivitetin e Prokurimit: Nr. 656 -20 – 1586 – 1- 2- 1 dhe

Nr. i brendshëm: 656 – 20 – 032 - 121

Sa i përket tenderit për: “Furnizimi me aterial higjenik për nevojat e administratës komunale dhe institucioneve tjera që janë në kuadër të komunës së Ferizajit

#### ANKESË

1. **Identifikimi i ankuesit\*** “N.P. T. “PASHTRIKU” Rr. Pal Palucaj Nr. 35 10000 Prishtinë – Republika e Kosovës

Komuna e Prishtinës  
(Vendi)  
mob. 044 159 238

10000  
(Kodi postar)

beni.dona@hotmail.com  
(Adresa elektronike)

z. Shaip Mustafa

22/06/2020  
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

\_\_\_\_\_  
(Emri i avokatit)

\_\_\_\_\_  
(Adresa e plotë)

\_\_\_\_\_  
(Numri i Telefonit)

\_\_\_\_\_  
(Numri i faks-it)

\_\_\_\_\_  
(Adresa elektronike)

\_\_\_\_\_  
(Data e parashtrimit të ankesës)

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

- ☐ Njoftimi për Kontratë i publikuar në web faqen e platëformës elektronike të KRPP-së dt. 24/04/2020;
- ☐ Afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë 05/05/2020 ora 13:30, Komuna e Ferizajit Zyra e Prokurimit 70000 Ferizaj Republika e Kosovës;
  - Kriter për dhënien e kontratës ka qenë çmimi më i ulët
- ☐ Hapja e ofertave nga ana e komisionit të AK-së është bërë më datë 05/05/2020 ora 13:30, Zyra e Prokurimit,
- ☐ Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues – Dhënie të kontratë i publikuar në ueb faqen e platformes elektronike të KRPP-së me datë 03/06/2020;
- ☐ Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar me datë 03/06/2020;
- ☐ rkesa për Rishqyrtim pranë Autoretit Kontraktues më datë 08/06/2020
  - ☐ Vendimi –njoftim mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 10/06/2020 i autoritetit kontraktues Komuna e Ferizajit Zyra e Prokurimit 70000 Ferizaj Republika e Kosovës;

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po



Jo



Është organizuar procesi i hapjes publike të ofertave. Asnjëri nga Operatorët Ekonomik të pranishëm në procesin e hapjes publike të ofertave nuk ka pasur vërejtje.

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet



*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:*

Jemi njoftuar me Letër standarde për ofertuesin e eliminuar

Po



Jo



#### **6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Operatori ekonomik N.P. T. "PASHTRIKU" Rr. Pal Palucaj Nr. 35 10000 Prishtinë – Republika e Kosovës në cilësi të palës së interesuar që ka interes juridik - material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit si dhe pas ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të dokumenteve të cilat e përbëjnë dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimit: Furnizimi me material higjienik për nevojat e administratës komunale dhe institucioneve tjera që janë në kuadër të komunës së Ferizajit me numër të aktivitetit të prokurimit 656 – 20 - 1584 – 1-2-1 dhe Nr. i brendshëm: 656 – 20 – 32 – 121

Ne në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar konsiderojmë se shpallja e Njoftimit për dhënie të kontratës operatorit ekonomik NT EL – SHPETIMI i publikuar në platëformën elektronike të e-prokurimit të KRPP-së më 03/06/2020 nga autoriteti kontraktues - Komuna e Ferizajit Rr. Dëshmorët e Kombit pn 70000 Ferizaj Republika e Kosovës është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92; -së si dhe të gjitha aktet tjera nën ligjore që kanë të bëjnë me prokurimin publik në Republikën e Kosovës. Në këtë mënyrë e ka dëmtuar rëndë interesin material-financiar të kompanisë në fitimin e kontratës publike në mënyrë të rregullt dhe ligjore.

Shkeljet e dispozitave ligjore nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Ferizajit Rr. Dëshmorët e Kombit pn 70000 Ferizaj Republika e Kosovës; pas pranimit të Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues –aktivitetit të prokurimit i publikuar në ueb faqen e platformes elektronike të KRPP-së me datë 03/06/2020;

- Është shkelur neni 1 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (qëllimi, shfrytëzimi më efikas, më transparent dhe më i drejtë i fondeve publike) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92;
  - Është shkelur neni 6 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (ekonomiciteti dhe efikasiteti i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92
  - Është shkelur neni 7 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Barazia në trajtim – Jo diskriminimi) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,
  - Është shkelur neni 52 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 ( Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,
  - Është shkelur neni 72 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,
  - Është shkelur neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve).
- Është shkelur neni 39 i RRUOPP-së (Sqarimi i tenderëve). –paragrafi 39.8
- Është shkelur neni 40 i RRUOPP-së (Krijimi i Komisioneve Velersuese të tenderve). –paragrafi 40.13
  - Është shkelur neni 41 i RRUOPP-së (Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve).

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## **7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*



- Është shkelur neni 6 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (ekonomiciteti dhe efikasiteti i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92
- Paragrafi 1 këtij neni thotë:
- 1. “Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit”.
- Për shkak të arsyetimeve të cekura më lartë i propozojmë Panelit Shqyrtues të OSHP-së pas shqyrtimit të kësaj ankese si dhe pas konstatimeve të ekspertit shqyrtues të mirren masa adekuate korrigjuese për eliminimin e lëshimeve ligjore dhe të vendoset që aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim me kontratë publike për aktivitetin e lartcekur të prokurimit të shpërblehet oferta e Operatorit Ekonomik N.P.T. “PASHTRIKU” Rr. Pal Palucaj Nr. 35 10000 Prishtinë – Republika e Kosovës ofertë e përgjegjsheme me çmimin më të ulët që plotëson të gjitha kriteret e specifikuar në Njoftimin për Kontratë dhe në dokumentet të cilat e përbëjnë dosjen e tenderit
- Është shkelur neni 7 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Barazia në trajtim – Jo diskriminimi) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92,
- Është shkelur neni 72 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92;

#### Neni 72

##### Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësuar certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Në letër standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 06/06/2020 në sqarim shkruan: “X Nuk keni përmbushur Kërkesat mbi kapacitetin ekonomik financiar dhe kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale”.

## Me tutje në ARSYETIM

Tenderi i juaj është refuzuar për këto arsye:

- Nuk keni përmbushur:
- 2. Kërkesat mbi kapacitetin ekonomik financiar duke u bazuar në kërkesat në dosjen e tenderit.
- 3. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe /ose profesionale – Kapacitetin teknik dhe profesional duke u bazuar në kërkesat në dosjen e tenderit.

Me datë 03/06/2020 përmes platëformës elektronike të e-prokurimit jemi njoftuar se me kontratë publike për aktivitetin e prokurimit Furnizimi me material higjienik për nevojat e administratës komunale dhe institucioneve tjera që janë në kuadër të komunës së Ferizajit me numër të aktivitetit të prokurimit 656 – 20 - 1584 – 1-2-1 dhe Nr. i brendshëm: 656 – 20 – 32 – 121 është propozuar që të shpërblehet me kontratë oferta e operatorit NT EL SHPETIMI Ferizaj 70000 Ferizaj për shumën e ofertes së dorëzuar nga ky operator ekonomik 58,000.50€ e cila ofertë është me çmim më të latë se oferta e jonë 58,000.50€ - 53,998.25 = 4,005.25 €. Që në rastin konkret nuk është shumë rëndësi ndryshimi i çmimit në mes të këyre dy ofertave sa është me rëndësi se oferta e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik N.P. T. "PASHTRIKU" Rr. Pal Palucaj Nr. 35 10000 Prishtinë – Republika e Kosovës është në përputhshmëri me kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë – pra është ofertë e përgjegjshme

Si duket komisioni për përvlerësimin e ofertave ose nuk ka qenë mjaft profesional ose nuk ka dashur që ti ekzaminoi krahasoi dhe vlerësoi të gjitha dokumentet të cilat kanë qenë ofertë, sepse shumën e kontratave të realizuara e tejkalon dukshëm shumën e cila është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit që kanë të bëjnë me kriteret të cilat ju i keni kërkuar.

### Provë:

Regjistri – lista e kontratave të realizuara për periudhën e kërkuar (2017, 2018 dhe 2019) si dhe referencat përkatëse.

Sipas këtij regjistri të kontratave të realizuara të dorëzuar se bashku me ofertë shumën e kontratave të realizuara për periudhën përkatëse arrinë shumën 156,520.68€

Në nenin 39 i RRUOPP-së ( Sqarimi i tenderëve) – paragrafi 39.8 thuhet:

*Shembujt e mëposhtëm nuk janë te vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet te veproj ne përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 te LPP-se*

Problemi	Si te vepohet?	Neni i LPP-se
<u>Mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave te prezantuar</u>	<u>Mund te kerkohen informata sqaruese</u>	<u>69</u>



40.1 Duke ju referuar nenit 59, paragrafi 1, i LPP-së, për të gjitha aktivitetet e prokurimit AK, respektivisht "ZKA" në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarin përgjegjës të prokurimit duhet të krijoj një komision të vlerësimit të tenderëve me funksione krejtësisht këshilluese për Zyrtarin përgjegjës të Prokurimit. Nga ky rregull përjashtohen aktivitetet e prokurimit me vlerë minimale. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të bëjë rekomandimin për anëtar të Komisionit të Vlerësimit të Tenderëve për ZKA, i cili do të aprovoj të gjitha nominimet ose kur është e nevojshme do të zgjedh anëtarë alternativ për Komisionin. Anëtarët e komisionit të hapjes së tenderëve mund të shërbejnë si anëtar të komisionit të vlerësimit.



Në vendimin – Përgjigjen në kërkesën tonë për rishqyrtim të dates 08/06/2020 me nr 01-125/2020 ju lutem shiheni se çka shkruen Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit.

## V E N D I M

“Në bazë të kërkesës për rishqyrtim të bërë nga NTP PASHTRIKU me datë 08/06/2020 për tenderin “Furnizimi me material higjenik për nevojat e administratës komunale dhe institucioneve tjera që janë në kuadër të komunës së Ferizajit me numër të prokurimit 656 – 20 – 1584 – 1 -2 – 1

## A R S Y E T I M

*“Pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim nga ana e juaj, ne si Autoritet Kontraktues konstatojmë se pikat ankimore të paraqitura në kërkesë janë të pa bazuara”.*

*Provë: VENDIMI Nr. 01-47/2020 i datës 14/05/2020*

Si duket komisioni për ri-vlerësimin e ofertave ose nuk ka qenë mjaft profesional ose nuk ka dashtur që t'i shtjelloi të gjitha dokumentat të cilat gjenden në dosje, sepse asnjë dokument i vetëm nuk mungon që ka të bëjë me kriteret të cilat Autoriteti kontraktues komuna e Ferizajit Rr. Dëshmorët e Kombit pn 70000 Ferizaj Republika e Kosovës i ka theksuar në Letër standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 06/05/2020

Prandej duke konsideruar se sqarimet të cilat i kemi dhënë në Kërkesë për Rishqyrtim dhe në këtë ankesë janë të mjaftueshme që paneli shqyrtues OSHP-së pas ekzaminimit vlerësimin dhe krahasimin të ofertave, të këtë konstatuar se oferta e jonë është ofertë e përgjegjshme me çmimin më të ulët kërkojmë nga AK Drejtoria e prokurimit Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit të formojë një komision për trajtimin e Kërkesës tonë për Rishqyrtim për aktivitetin e lartcekur të prokurimit dhe pas shqyrtimit dhe marrjes në konsideratë si dhe duke iu dhënë peshë të gjitha fakteve të paraqitura në ankesë - kërkesë për Rishqyrtim dhe pas veprimeve korrigjuese, i propozojmë të merr këtë:

## V E N D I M

- **MIRATOHET** si e bazuar Ankesa e Operatorit Ekonomik “N.P. T. “PASHTRIKU” Rr. Pal Palucaj Nr. 35 10000 Prishtinë – Republika e Kosovës
- 
- **ANULOHE**T Vendimi, përkatësisht Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues – dhënie e kontratës për aktivitetin e lartcekur të prokurimit i publikuar në ueb faqen e platëformës elektronike të KRPP-së me datë 03/06/2020.
- Të mirren masa adekuate korrigjuese për eliminimin e lëshimeve ligjore dhe të vendoset që me kontratë publike për aktivitetin e lartcekur të prokurimit të shpërblehet oferta e Operatorit Ekonomik “N.P. T. “PASHTRIKU” Rr. Pal Palucaj Nr. 35 10000 Prishtinë – Republika e Kosovës si ofertë e përgjegjshme me çmimin më të ulët që plotëson të gjitha kriteret e specifikuar në Njoftimin për Kontratë dhe në dokumentet të cilat e përbëjnë dosjen e tenderit.

## 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:*

Dëmet materiale janë të konsiderueshme që kanë të bëjnë me përgatitjen e dosjes së tenderit:

Përgatitja e dy Kërkesave për Rishqyrtim

Përgatitja e dy ankesave,

Dëmet më të mëdha do t'i shkatohen Operatorit Ekonomik "N.P. T. "PASHTRIKU" Rr. Pal Palucaj Nr. 35 10000 Prishtinë – Republika e Kosovës nëse oferta nuk do të shpërblehet me kontratë publike për aktivitetin e lartëcekur të prokurimit.

Të gjitha dëmet materiale do të konstatohen në të ardhmën nga ekspertët e autorizuar ligjorë përkatës gjatë zhvillimit të procedurës.

## 9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) Një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë";
- b) Një kopje të procesverbalit të hapjes së ofertave;
- c) Një kopje të Njoftimit për Dhënie të Kontratës i publikuar në ueb faqën e platformës elektronike të KRPP-së me datë 03/06/2020;
- d) Një kopje të Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 03/06/2020;
- e) Si dhe të gjitha korrespondencat të cilat janë zhvillu prej Autoritetit Kontraktues dhe Operatoreve Ekonomik.
- f) Kërkesa për rishqyrtim e dorëzuar pranë autoritetit kontraktues komuna e Ferizajit Rr. Dëshmorët e Kombit pn 70000 Ferizaj Republika e Kosovës me datë 08/06/2020;
- g) Vendimi –njoftim mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 10/06/2020 i autoritetit kontraktues Komuna e Ferizajit Zyra e Prokurimit 70000 Ferizaj Republika e Kosovës;

**\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, originalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.**